



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenit 14, paragrafi 1 dhe 2, lidhur me paragrafin 3, të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019”, e konform nenit 6, pika 3, lidhur me nenin 8 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe neneve 15, 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë ----- miratoi këtë:

### Projekt-V E N D I M

#### Neni 1

**JEPET PËLQIMI**- për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër prej 1, (një) deri në 15, (pesëmbëdhjetë) vite të pronave të paluajtshme të Komunës, si vijon:

- 1.1 Parcela **P-72116038-00503-0**, me sipërfaqe prej: **S=28302m<sup>2</sup>**, në vendin e quajtur **“Ledina e Vogel”** zona kadastrale Samadrexhë, sipas certifikatës së pronës Nr. 3041/2022 të datës 05.08.2022, në emër të Komunës së Suharekës, nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lart ndahen për dhënien në shfrytëzim **S=7500m<sup>2</sup>** për ushtrimin e veprimtarisë **“Bujqësore”** dhe
- 1.2 Parcela **P-72116003-00944-0**, me sipërfaqe prej: **S=52470m<sup>2</sup>**, në vendin e quajtur **“Shkoza Zlavacia/Zhkoza”** zona kadastrale Bllacë, sipas certifikatës së pronës Nr. 3045/2022 të datës 05.08.2022, në emër të Komunës së Suharekës, nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lart ndahen për dhënien në shfrytëzim **S=30000m<sup>2</sup>** për ushtrimin e veprimtarisë **“Bujqësore”**.

#### Neni 2

**OBLIGOHET**-Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastër dhe zyra e prokurimit që në bashkëpunim me komisioni për zbatimin procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, afatshkurtër dhe afatgjatë, që të zhvilloj procedurat e ankandit publik, konform dispozitave të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019” dhe Rregurores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

#### Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

### KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË

01-Nr-\_\_\_\_\_  
Më datë\_\_\_\_\_

Kryesuesi i Kuvendit  
\_\_\_\_\_  
Mr.ec Bexhet KUÇI